

20250751658

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË SIGURIMT PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 160/14, 160/14 15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 27/18, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22, 79/23 dhe 193/24), në nenin 37, paragrafi (1), pas fjalës “bëhet”, shtohen fjalët “shfrytëzuesve të pensionit të cilëve pensioni u paguhet në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 2

Në nenin 160, pika 6) në fjalinë hyrëse fshihen fjalët "jo më të vjetër se pesë vite".

Në nënpikën 5, lidhësja "ose" zëvendësohet me presje.

Në nënpikën 6, pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhësen "ose".

Pas nënpikës 6, shtohet një nënpikë e re 7 si vijon:

“- posedon vërtetim dhe/ose certifikatë me të cilat dëshmohet njohja e njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit European (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht) në nivelin B2 të Kornizës Europiane të Referencës për Gjuhët, të lëshuar nga një institucion brenda shtetit ose jashtë vendit, të regjistruar si ofrues i këtij shërbimi.“.

Neni 3

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 193/24), në nenin 18, paragrafi (3), pas fjalës “28 shkurt 2025” shtohen fjalët “dhe që paguhet në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.